



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KESHILLI BASHKIAK  
GRAMSH

Nr. 1713/2 Prot

Gramsh më 23.05.2024

V E N D I M

Nr. 32 datë. 29 . 04.2024

PËR  
MIRATIMIN E PROJEKTIT TEKNIK "RIKONSTRUKSIONI I SHKOLLËS 9-  
VJEÇARE RILINDJA"

Këshilli i Bashkisë Gramsh, në mbledhjet e tij të datës 29/04/2024, pasi mori në shqyrtim relacionin e paraqitur nga Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit dhe Drejtoria e Financës dhe Buxhetit "Për Projektin Teknik "Rikonstruksioni i Shkollës 9-vjeçare Rilindja", mbështetur në Ligjin Nr. 139/2015 datë 17.12.2015 "Per qeverisjen vendore" neni 41 pika 2/ç, Ligji Nr. 68 datë 27.4.2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore", Ligjin Nr. 9936 datë 26.06.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar, Ligji Nr. 162 datë datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" i ndryshuar, VKM-së Nr. 258, date 19.05.2021" Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik, i ndryshuar neni 12 dhe 13 i tij, VKB Nr. 88 datë 27.12.2023 "Për miratimin e programit buxhetor për vitin 2024 të Bashkisë Gramsh", si dhe shkresës Nr. 1815/5Prot, datë 27.03.2024 të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit me lëndë Dërgohet çelja e fondeve në grupin e shpenzimeve kapitale për projektet me cikël financimi 2024 2026.

V E N D O S I

1. Të miratojë projektin "Rikonstruksioni i Shkollës 9-vjeçare Rilindja" në vlerën totale 111,068,046 (njëqind e njëmbëdhjetë million e gjashtëdhjet e tetë mijë e dyzet e gjashtë) lekë me TVSH.
2. Vlera e financimit nga Ministria e Arsimit dhe Sportit do të jetë 94,407,839 (nëntëdhjet e katër milion e katërqind e shtatë mijë e tetëqind e tridhjet e nëntë) lekë me TVSH, e ndarë në:
  - Viti 2024 në vlerën 23,000,000 (njëzet e tre milion) lekë me TVSH.
  - Viti 2024 në vlerën 71,407,839 (shtatëdhjet e një million e katërqind e shtatë mijë e tetëqind e tridhjet e nëntë) lekë me TVSH.

3. Vlera e financimit prej 16,660,207 (gjashtëmbëdhjetë milion e gjashtëqind e gjashtëdhjetë mijë e dyqind e shtatë) lekë me TVSH do financohen nga buxheti i Bashkisë Gramsh për vitin 2025
4. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohen Kryetari i Bashkisë, Drejtoria e Financës dhe buxhetit dhe Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit.
5. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

**Kryetari i Këshillit të Bashkisë**

**Enis ZANI**



Sede Finances  
Sek - Keshillit  
Dr. P. Jemilenti

BASHKIA GRAMSH  
NR REGJ 1713/3  
Mbërriti me Date



14.05.2024

REPUBLIKA E SHQIPERISE  
PREFEKTI I QARKUT ELBASAN  
SEKTORI I MONITORIMIT TË KOMPETENCAVE VENDORE DHE FUNKSIONEVE TË  
DELEGUARA

Nr. 577/prot.

Elbasan, më 13.5.2024

Lënda: Konfirmim akti mbi miratimin e projektit teknik për rikonstruksion shkolle.

KËSHILLIT BASHKIAK GRAMSH

Në zbatim të nenit 16 të ligjit Nr.107/2016 dt.27.10.2016, "Për Prefektin e Qarkut", pasi u verifikua ligjshmëria e aktit tuaj Nr.32 datë 29.04.2024, "Për miratimin e projektit teknik "Rikonstruksion i Shkollës 9- Vjeçare Rilindja" ", konfirmojmë në parim mbështetjen e tij në ligji.

REPUBLIKA E SHQIPERISE  
PREFEKTI  
Majlinda PERRIU